

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 3, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ dhe neni 41, paragrafi (1) dhe paragrafi (6) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 42, paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-3632/1 të datës 22.08.2025 dhe Njoftimin për ndryshimin e strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ANTENA 5 Petrov, Janev dhe Gushev ShPK Shkup (PA1 nr.02-216 të datës 31.07.2026), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit, (nr.ark.02-3207/4 të datës 25.08.2026), Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjatë seancës së 29-të të mbajtur më 25.08.2026, miratoi:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup, dhe atë:

- për heqjen e personit fizik [REDAKTUAR] me pjesëmarrje prej 33,3% në kapitalin bazë dhe
- për hyrjen e personit fizik [REDAKTUAR] dhe adresë në rr." [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 33,3% në kapitalin bazë.

2. Detyrohet që Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup, pas ndryshimit të kryer të paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele të dorëzoj gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup, është e detyruar të zbaton ndryshimin e strukturës pronësore nga pika 1 e këtij Vendimi dhe në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e miratimit të këtij Vendimi. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e përcaktuar, ky vendim do të anulohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevska dhe Gushev ShPK Shkup, në pajtim me nenin 41, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV-së) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.171/14), për ndryshimin e strukturës pronësore (PA1 nr. 02-216 të datës 31.07.2026), ka njoftuar Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e zbatimit të ndryshimit të strukturës pronësore të ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup. Njëkohësisht, transmetuesi ka njoftuar Agjencinë se Njoftimin për ndryshimin e strukturës pronësore e ka dorëzuar pas zbatimit të procedurës trashëguuese, sipas së cilës trashëgimtar ligjor i pjesës së njërit prej pronarëve, personit [REDAKTUAR] (i mëparshëm) është personi fizik [REDAKTUAR].

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës pronësore (PA1 nr. 02-216 të datës 31.07.2026) nga ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup, u konstatua se është i plotë dhe i rregullt, përkatësisht i përmbante të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore.

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

Agjencia me qëllim që të hetojë nëse me ndryshimet e propozuara në strukturën pronësore të ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup, do të krijohet përqendrim i paautorizuar mediatik, përkatësisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga LShMAAV-së, nëpërmjet Sistemit të Shpërndarjes së Internetit të Regjistrimit Qendror të RMV-së, ka siguruar informacion mbi lidhshmërinë e subjekteve (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendjen vijuese, [REDAKTUAR] të datës 20.08.2026, nga ku është dukshëm se personi Jelena Jovanovska nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare.

Gjithashtu, Agjencia ka kryer kontroll dhe në Regjistrin e pronarëve përfitues (të vërtetë) që mbahet nga Regjistri Qendror, nga ku siguroi dokument për “Gjendjen vijuese të personit fizik – pronarit përfitues” [REDAKTUAR] me nr. [REDAKTUAR] të datës 20.08.2026, ku është konstatuar se ky person nuk është i evidentuar si pronar përfitues në asnjë subjekt juridik.

Pas ndryshimit të kryer të strukturës pronësore, pronarët e ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup do të jenë: [REDAKTUAR] dhe adresë në rr. [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 33,3 % në kapitalin bazë; Jelena Jovanovska, me NVAQ [REDAKTUAR] me pjesëmarrje prej 33,3 % në kapitalin bazë dhe Marjan Gushev, me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr. [REDAKTUAR] Shkup, me pjesëmarrje prej 33,3 % në kapitalin bazë.

ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup është e detyruar të zbatojë ndryshimin e strukturës pronësore nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e miratimit të këtij Vendimi. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e përcaktuar, ky vendim do të anulohet.

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se me zbatimin e ndryshimit të strukturës pronësore të ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup, nuk krijohet përqendrim i paautorizuar mediatik sipas LShMAAV-së, përkatësisht se ky ndryshim nuk bie në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35, paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të paraqitur për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR RADIO ANTENA 5 Petrov, Janevski dhe Gushev ShPK Shkup PA1 nr.02-216 të datës 31.07.2026, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim si në dispozitiv.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, transmetuesi nëse është i pakënaqur nga vendimi, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të ngrejë padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Përktheu: Antonea Shabani